



# SI FUNKSIONOJNË



# INSTITUCIONET

## NE DHE KUVENDI

AGNESA (12), ALBION (12), ELSA (11), DRITON (12), ANESA (12), ALDIN (12), DAFINA (12), OLSA (11)



### Kuvendi i Kosovës dhe qeverisja

Deputetët e Kuvendit të Kosovës në seanca plenare debatojnë dhe votojnë për ligjet, por ata gjithashtu flasin për çështje të ndryshme. Nxerrja e ligjeve është



njëri nga funksionet kryesore të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Qytetarët i zgjedhin këtë deputetë përmes votave të tyre. Vota duhet të jetë e lirë dhe e fshehtë. Çdo qytetar mbi moshën 18 vjeçare, ka të drejtë të votojë dhe të zgjedhë përfaqësuesit e tij. Qeverinë e zgjedhin deputetët e Kuvendit të Kosovës me shumicën e votave dhe gjithashtu e zgjedhin Presidentin e vendit.

Në bazë të Kushtetutës së Kosovës, Kuvendi i Kosovës ushtron pushtetin legjislativ. Kuvendi i Kosovës miraton edhe buxhetin e vendit tonë, e që është

shumë i rëndësishëm për zhvillimin e vendit. Kuvendi i mban mbledhjet plenare të rregullta, por punën më të madhe deputetët e bëjnë në komisionet parlamentare. Në komisione parlamentare diskutohet për çështje të ndryshme. Ata diskutojnë për projektligjet, propozojnë ndryshime dhe plotësime të projektligjeve. Këto ndryshime dhe plotësime që propozohen, quhen amendamente.

Pjesë e Kuvendit janë deputetët e pozitës dhe opozitës, dhe si pozita ashtu dhe opozita janë të përbërë nga deputetë të zgjedhur nga populli dhe përfaqësojnë interesat e tyre. Çdo person mbi 18 vjeç mund të kandidojë për deputet, dhe mund të jetë pjesë e një partie politike, iniciative qytetare, apo edhe të jetë kandidat i pavarur.



Këta janë autorët e artikullit

# POPULLI NË DEMOKRACI

ARES (11), ERNIS (12), VERONA (12), VERONA (12), DRENI (12), FATIMJA (12)

## Ç'është demokracia?

Demokracia është liria e të shprehurit, zgjedhja e lirë profesionit në të ardhmen, të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët, etj. Fjala demokraci rrjedh nga greqishtja e vjetër, ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratos“ do të thotë fuqi. Kjo do të thotë se demokracia shprehje e fuqisë së popullit.

Kjo qeverisje ndahet në dy forma, në demokracinë e drejtpërdrejtë dhe atë përfaqësuese. Në demokraci vendimet merren me anë të votave. Fillet e saj janë në Greqinë e lashtë, edhe pse me kalimin e kohës ajo ka ndryshuar.

Tashmë kemi shumë të drejta, p.sh. të drejtën e arsimit, të drejtën e punësimit, apo edhe të drejtat që mbrojnë fëmijët.



Autorët e artikullit duke bashkëpunuar



Unë mendoj që në demokraci të gjithë janë të barabartë pa dallim gjinie apo moshe.

Shprehja e mendimit të lirë pa dallime



Unë kam zgjedhur profesionin që dëshiroja, pra inxhinier.

Zgjedhja e lirë e profesionit të dëshiruar



Kush është për...?

Në demokraci vendimet merren duke votuar



Demokracia është rruga drejt paqes

# ZGJEDHJET NË KOSOVË KANË RËNDËSI

RREZARTA (12), ERONA (11), ALTINI (12), ARLIND (12), ALBERT (12), GENTRESA (12), DIAMANTA (12)

## Mësojmë për zgjedhjet dhe llojet e zgjedhjeve

Vetë titulli „Zgjedhjet në Kosovë“ na tregon se zgjedhjet janë shumë të rëndësishme. Ne kemi të drejtë të votojmë nga moshën 18 vjeçare. Të drejtën e votës e kanë edhe personat që janë në burg, pasi që një votë e vetme ka shumë rëndësi dhe bën ndryshimin. Zgjedhjet ndahen: zgjedhje komunale dhe ato qendrore. Në Kosovë, pas luftës ka pasur ndryshime të vogla në zgjedhje. Ato mbahen çdo katër vjet. Kjo do të thotë se zgjedhjet e ardhshme do të mbahen pas dy vjetëve. Një lider duhet të ketë cilësi të mira. Ai duhet të jetë i ndershëm, të jetë i besueshëm, të ketë karakter të mirë, etj. Zgjedhjet janë të rëndësishme, prandaj të gjithë duhet të votojmë.



Autorët e artikullit



Vota jote mund të sjell ndryshim në vend



E drejta e votimit



Llojet e zgjedhjeve në Kosovë



Edhe unë do të votoj nga moshën 18 vjeçare

## KUVENDI, GJYKATAT DHE QEVERIA

MJELLMA (11), LEOTRIM (12), BLENDI (12), FLORENT (13), HAKI (12), LEART (12), ALBRIM (12)

### Si zbatohet demokracia në Kosovë, përgjigjen qytetarët

Ne sot kemi mësuar për tri institucionet kryesore në demokraci, të cilat janë: Qeveria, Kuvendi, Gjykata. Këto përbëjnë tri degët e pushtetit: Pushtetin Legjislativ, Ekzekutiv, dhe atë Gjyqësor.

Kuvendi i shkruan ligjet, Qeveria i zbaton ato, ndërsa Gjykatat marrin vendime duke zbatuar dhe respektuar nenet e Kushtetutës. Kushtetuta përmban nenet, përmes të cilave funksionon shteti ynë demokratik. Në një proces gjyqësor bëjnë pjesë: gjykatësi, avokati apo mbrojtësi ligjor, prokurori dhe i dyshuari. Në Kuvend deputetët nxjerrin ligje, dhe përbëhet nga deputetët e pozitës dhe të opozitës. Ndërsa Qeveria përbëhet nga Kryeministri, zv.kryeministra, ministrat dhe zv.ministriat. Këto institucione janë të pavarura

nga njëra-tjetra, dhe të gjitha lidhen me demokracinë.

Për të mësuar më shumë për demokracinë dhe ndarjen e pushtetit, ne kemi dalur sot në sheshin e Prishtinës, dhe atje kemi bërë disa intervista të shkurta me qytetarët dhe ata na kanë dhënë disa përgjigje pozitive. Qytetarët na thanë se ata duhet të jenë sa më aktiv për vendin e tyre. Të gjithë duhet të respektojnë rregullat e demokracisë dhe të protestojnë vetëm në mënyrë paqësore. Njëri nga ta tha se demokracia funksionon aq sa funksionojnë qytetarët, dhe njëra nga format se si qytetarët marrin pjesë në demokraci është përmes zgjedhjeve demokratike. Ne mendojmë se të gjithë ne duhet të respektojmë ligjet, në mënyrë që institucionet të jenë të pavarura dhe të drejta për qytetarët.




Autorët e artikullit pyesin gjatë intervistave



Ne, në intervistë me deputetin e Kuvendit të Kosovës



Të gjithë janë të barabartë para ligjit



Qytetarët përgjigjen pozitivisht mbi demokracinë në vend



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@toka-ks.org](mailto:info@toka-ks.org)  
Website: [www.toka-ks.org](http://www.toka-ks.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Afrim Gashi“  
Klasa: VII-1  
Vendi: Hajvali, Prishtinë